

DREJTORIA ARSIMORE E FILADEFIAS
ZYRA E SHERBIMEVE PER PRINDERIT, FAMILJEN DHE KOMUNITETIN
440 NORTH BROAD STREET, DHOMA. 114
PHILADELPHIA, PENNSYLVANIA 19130

JAMES W. SCOTT
DREJTOR

TELEFON: (215)400-6344
FAKS: (215)400-4181

1 Dhjetor, 2011

Të dashur prindër dhe kujdestarë:

Bashkë me këtë letër po ju dërgojmë një kopje të Politikës së Përfshirjes së Prindërve të Mbarë Distriktit sipas Title I të Drejtorisë Arsimore.

Çfarë është Title I?

Title I është një paragraf i ligjit të quajtur "Asnjë fëmijë të mos ngelet mbrapa," miratuar nga Kongresi në vitin 2002. Ky ligj përmban paragrafe për shkollat publike të ciklit të ulët dhe të lartë në tema të tilla si përdorimi i fondeve federale, trainimeve të mësuesve, arritjeve akademike, të drejtave të prindërve, udhëzime për nxënësit e arsimit special, si edhe paanësi në atletikë.

Çfarë është Politika e Drejtorisë Arsimore e Përfshirjes së Prindërve të Mbarë Distriktit?

Kjo politikë tregon se si Drejtoria Arsimore do të sigurojë, që prindërit të luajnë një rol domethënës në edukimin e fëmijëve të tyre dhe se si ajo do të koordinojë aktivitetet për angazhimin e prindërve në të gjitha zyrat. Çdo shkollë e drejtorisë arsimore që merr fonde nga Title I për atë popullsi nxënësish, të cilët janë në disavantazh ekonomik i kërkohet të aprovojë një politikë për angazhimin e prindërve.

Politika e Drejtorisë së onë u mbështet nga mendimet e kryetarëve të prindërve. Ndërmjet gjërave të tjera, kjo politikë propozon që t'i sigurojë prindërve informacion në kohë të mjaftueshme në gjuhë të ndryshme; të sigurojë mundësi edukative për të mësuar lidhur me programin mësimor, testimeve, dhe temave të tjera; të përmirësojë mënyrën se si mendimet e prindërve të përfshihen në planifikimin e përmirësimit të shkollës; të rrisë dhe t'i japë larmi Komitetit të Këshillit të Prindërve për Title I.

Pse është politika e rëndësishme për ju?

Kjo Politikë e Drejtorisë tregon se çfarë lajmërimesh dhe informacioni prindërit kanë të drejtë të marrin; çfarë aktivitete shkollore dhe të drejtorisë kërkohen të marrin mendimin e prindërve; çfarë masash planifikon të marrë për mënjanimin e pengesave të pjesëmarrjes së prindërve/kujdestarëve; dhe çfarë lloj bashkëpunimi Drejtoria planifikon të ketë me shoqatat e Lidhjes së familjes me shkollën dhe organizata të tjera të prindërve. Reagimet e prindërve/kujdestarëve ndaj kësaj politike do t'i përcillen Departamentit të Edukimit të Pensilvanisë së bashku me politikën e përfshirjes së prindërve.

Shpresojmë që ju të bashkëpunoni me zyrën tonë për mbështetjen e fëmijës suaj. Një nga mënyrat më të mira për përmirësimin e arritjeve akademike të nxënësve është që, prindërit dhe kujdestarët të marrin pjesë në mënyrë aktive në takimet e shkollës, aktivitetet me familjen, në Shoqatën Shkollë-Familje të zonës ose grupe të tjera të prindërve si edhe qeverisjes së shkollës.

Sinqerisht,

James W. Scott,
Drejtore
Zyrae Prindit, Komunitetit dhe
Partneriteteve të Besimit